

1 E martë, 2 korrik 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.01

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretare e
6 seancës, paraqisni lëndën.

7 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjesi, të
8 nderuar. Lënda KSC-BC-2020-06, Prokurori i Specializuar kundër
9 Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup
10 Krasniqit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për shkak të
12 procesverbalit, shprehem se të gjithë të akuzuarit janë të
13 pranishëm. Dhe sot do të vijojmë me Dëshmitarin W04752.

14 Dhe gjithashtu në lidhje me provat që janë pranuar dje.

15 Dje kemi patur provën SPOE00225789 deri SPOE00225790, të
16 cilat janë dorëzuar nga Prokuroria me dy faqe, por vetëm një
17 nga këto dy faqe SPOE00225789 u pasqyrua si e pranuar në
18 procesverbal dhe për shkak të procesverbalit, në fakt, ishte
19 gabimi im, pavarësisht Sekretares së seancës.

20 Kështu që Paneli sqaron që të dyja faqet SPOE00225789
21 deri në SPOE00225790 u pranuan, pra, që të dyja si prova
22 materiale P1396.

23 Dhe tani do të vijojmë me dëshminë e dëshmitarit të
24 Prokurorisë, Dëshmitarin W04752.

25 Sekretare e Seancës, ju lutem sillni në sallë

1 dëshmitarin.

2 [Dëshmitari vijon dëshminë]

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjesi,
4 z. Zyrapi. Besoj që ia keni kaluar mirë mbrëmë.

5 DËSHMITARI: Mirëmëngjesi. Po, faleminderit.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju kujtoj që
7 të përpiqeni që t'u përgjigjeni pyetjeve qartazi me fjali të
8 shkurtra. Dhe në rast se nuk i kuptoni pyetjet kërkoni që
9 pyetjet të përsëriten ose thoni që nuk e kuptoni dhe ata do ta
10 sqarojnë.

11 Gjithashtu, përpiquni që të na tregoni se cila është bazë
12 mbi të cilën i bazoni këto njohuri, pra, për pyetjet që do
13 t'ju bëjnë.

14 Gjithashtu, flisni përpara mikrofonit dhe prisni pesë
15 sekonda përpara se të përgjigjeni, gjithashtu flisni me një
16 ritëm të ngadaltë në mënyrë që përkthyesit të kenë mundësi të
17 përkthejnë gjithçka.

18 Në rast se do të keni nevojë për ndonjë pushim, ju lutem
19 na thoni dhe patjetër do të bëjmë organizimet e duhura.

20 Ju kujtoj dhe një herë që vazhdoni të jeni nën detyrimin
21 që të tregoni të vërtetën ashtu siç keni thënë gjatë betimit.

22 Ju kujtoj gjithashtu, që ashtu siç ju tha edhe dje, nuk
23 kërkohet që ju t'i përgjigjeni ndonjë pyetjeje që mund të jetë
24 vetinkriminuese vetëm në ato raste kur Paneli ju thotë që
25 duhet patjetër t'u përgjigjeni këtyre pyetjeve dhe në rast se

1 del një gjë e tillë, atëherë ju keni Avokatin pranë jush që do
2 t'ju shpjegoj dhe Paneli do të vendosë në ç'rrethana do të
3 duhet të detyroheni të përgjigjeni apo jo.

4 Kështu që do të vijojmë tani me pyetje të Prokurorisë.
5 Mund të tregoni vëmendjen e duhur për ato pyetje.

6 Dhe fjala për Prokuroren.

7 DËSHMITARI: BISLIM ZYRAPI [Vijon]

8 Pyetje nga znj. Lawson: [Vazhdon]

9 ZNJ. LAWSON: [Përkthim]

10 PY. Mirëmëngjesi.

11 PË. Mirëmëngjesi.

12 PY. Kur mbaruam dje, ne po shikonim një dokument që kishte të
13 bënte me drejtorinë për financat. Dëshiroj gjithashtu që të
14 vijojmë me një dokument tjetër në këtë vazhdë.

15 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Është dokumenti SPOE00225266.

16 PY. A mund të na shpjegoni se çfarë është kjo gjë këtu?

17 PË. Kjo është një kërkesë nga një komandant i logjistikës,
18 njësisë së logjistikës pranë Shtabit të Përgjithshëm, i cili
19 ka kërkuar mjete teknike për mbarëvajtjen e punës së tij.

20 PY. A e njihni emrin e këtij eprori?

21 PË. Po.

22 PY. Çfarë roli kishte ai?

23 PË. Komandant i kompanisë së logjistikës pranë Shtabit të
24 Përgjithshëm.

25 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] A mund të kalojmë pak më poshtë

Dëshmitari: Bislir Zyrapi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Lawson (Vazhdim)

Faqe 4

1 në këtë faqe tek gjuha shqipe, ju lutem.

2 PY. E shikoni kush e ka miratuar atë kërkesë, e njihni atë
3 emër?

4 PË. Po.

5 PY. A mund të na thoni se kush është?

6 PË. Është nënshkrimi i Jakup Krasniqit.

7 PY. A e kishte kompetencën, autoritetin e duhur për ta bërë
8 këtë gjë

9 PË. Po.

10 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Ju kërkoj që ky dokument të
11 paraqitet si provë.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka
13 kundërshtime?

14 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Dëshmitar, nuk ka thënë që e
15 ka parë këtë dokument më parë, as që e ka përgatitur atë më
16 parë.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].
18 [Përkthim] Ky nuk është kundërshtim. Kundërshtimi
19 rrëzohet.

20 Për këtë arsye SPOE00225266 pranohet.

21 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Atëherë numri që do të
22 marrë kjo provë materiale do të jetë P01400. Me klasifikimin
23 si konfidencial.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]
25 Riklasifikoheni si dokument publik.

1 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit.

2 ZNJ. LAWSON: [Përkthim]

3 PY. Dje ju na shpjeguar se ndërmjet nëntorit 1998 dhe marsit
4 1999, ku qëndronte Shtabi i Përgjithshëm në ç`vendndodhje dhe
5 unë dëshiroja t`ju tregoja një dokument por nuk e gjetëm dot
6 dje. Kështu që dëshiroj t`i kthehem këtij dokumenti.

7 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Me numrin SPOE0082284 në gjuhën
8 angleze. Dhe në gjuhën shqipe SPOE0082262. Dhe fillojmë nga
9 faqja 285 e të dyja gjuhëve dhe mund të shfaqet në ekran për
10 publikun. Faleminderit. Do t`ju lutesha që të kalonim pak më
11 poshtë në faqe. Po. faleminderit.

12 PY. Besoj se e shikoni hartën këtu përpara me gjithë
13 legjendën e saj poshtë. A mund të konfirmoni nëse numri 2, 3
14 për Divjakë dhe 5 për Kleçkën janë të saktë.

15 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Nëse mund të kalojmë pak lart në
16 faqe që të duket dhe numri 2 në hartë.

17 DËSHMITARI: Po.

18 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Atëherë kalojmë tek faqja 287, në
19 të dy dokumentet.

20 PY. A e njihni ndërtesën në këtë fotografinë lart në fillim
21 të faqes?

22 PË. Po, është selia e komandës së Brigadës 121.

23 PY. Keni qenë atje?

24 PË. Po.

25 PY. Po fotografinë e dytë, e mbani mend këtë ngjarje?

1 PË. Po. Kjo është një qershor në atë kohë kur unë kam
2 ndihmuar dhe shpjeguar se si bëhet raporti, rreshtimi i
3 njësive, përshëndetjet.

4 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Ju lutem të kalojmë pak poshtë
5 tek pjesa e fundit e faqes për të parë fotografinë e fundit.

6 PY. A e njihni personat në këtë fotografi dhe, në rast se po,
7 cilat janë emrat e tyre, ju lutem?

8 PË. Po, i njof. Në këtë fotografi është Jakup Krasniqi,
9 Fatmir Limaj dhe Ferat Shala.

10 PY. A mund të na tregoni se ku janë këta, secili prej këtyre
11 personave në fotografi? Pra, kur kemi fotografinë përballë
12 personi në të majtë, kush është ai?

13 PË. Personi në të majtë është Ferat Shala.

14 PY. Dhe në qendër?

15 PË. Në qendër është Jakup Krasniqi. Dhe në të djathtë është
16 Fatmir Limaj.

17 PY. A e dini se ku është marrë kjo fotografi?

18 PË. Nuk më kujtohet. Nuk e di.

19 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] A mund të shkojmë tani tek faqja
20 289, ju lutem?

21 PY. Atëherë fillojmë me fotografinë lart në të majtë. A e
22 njihni atë ndërtesë?

23 PË. Po.

24 PY. Mund të na shpjegoni se çfarë është, ku ndodhet dhe kush
25 qëndronte aty?

1 PË. Kjo është shtëpia në fshatin Divjakë, pjesë e Shtabit të
2 Përgjithshëm. Në këtë shtëpi kanë qëndruar Jakup Krasniqi,
3 Ramë Buja, Sokol Dobruna.

4 PY. Dhe ne mund të shikojmë që është edhe një ndërtesë tjetër
5 ngjitur me to ose më saktë është ndërtesa e bardhë dhe pastaj
6 ngjitur me të është një ndërtesë tjetër. Çfarë është ajo?

7 PË. Ajo ndërtesë nuk është e ngjitur. Pak është më e shkurtër
8 prej kësaj ndërtese. Dhe aty ka qenun logjistika e vendosur,
9 kompania e logjistikës së Shtabit të Përgjithshëm.

10 PY. Fotografia lart në të djathtë të asaj faqeje, a e njihni
11 atë ndërtesë çfarë është ajo?

12 PY. Po. Kjo është ndërtesa e njëjtë në fshatin Divjakë, është
13 pjesë e Shtabit të Përgjithshëm, këtu kam qëndruar unë, bashkë
14 me drejtorinë operative dhe drejtorinë e komunikimit.

15 PY. Fotografia poshtë saj, pra, e dyta në të djathtë, a e
16 njihni atë dhe mund të na shpjegoni sërish se çfarë ndërtese
17 ka qenë ajo?

18 PË. Po e njëjtë ndërtesa e tretë në fshatin Divjakë, pjesë e
19 Shtabit të Përgjithshëm, e cilën kanë qenë të vendosur policia
20 ushtarake, e cila ka siguruar Shtabin e Përgjithshëm.

21 PY. Po ndërtesa që është e dyta poshtë në të majtë?

22 PË. Ajo tani është e shkatërrime, po në atëkohë ka qenë
23 funksionale dhe kanë qenë pjesë ku kanë qenë vendosun njësitë
24 këto vëzhguese pranë Shtabit të Përgjithshëm, ça më kujtohet.

25 PY. Atëherë kalojmë tani tek fotografitë në fund të faqes, në

1 të majtë në fund, a i njihni se kush është në atë fotografi,
2 kush është personi aty?

3 PË. Po. Është Jakup Krasniqi.

4 PY. A e mbani mend ngjarjen e cila tregohet nga fotografia?

5 PË. Kjo në dhjetor të 1998, më duket është koha -- nuk më
6 kujtohet saktë cila ka qenë.

7 PY. Dhe fotografia në fund të faqes në të djathtë, a i njihni
8 personat në atë fotografi?

9 PË. Po.

10 PY. Atëherë duke filluar nga personi që është më pranë
11 fotografit ose nesh, a mund t'i identifikoni të gjithë me
12 radhë ju lutem?

13 PË. Po. I pari është Mësuesi. Është eprori i komandës 121,
14 Brigadës 121, që ka qenë. Dyti është Musë Jashari, është
15 komandant i zonës, drejtori operativ në këtë kohë -- dhe
16 drejtor i komunikimit në këtë kohë. Pastaj është Naim Maloku i
17 drejtorisë operative. Nuk po e shof mirë fotografinë. Pastaj
18 është Fatmir Limaj, që më kujtohet që po e shof. Pastaj Jakup
19 Krasniqi dhe më në fund andej Ramë Buja.

20 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Tani mund të kalojmë në faqen
21 291, faleminderit.

22 PY. Dhe fotografinë në fund të faqes, të na e shfaqin në
23 ekran, ju lutem. E njihni çfarë është kjo ndërtesë, mund të na
24 e shpjegoni dhe atë sërish, ju lutem?

25 PË. Po. Ky objekt është në Fshatin e Ri ose ndryshe Novosellë

1 në bjeshkët e Berishës. Në këtë vend ka qëndruar ose ka qenë e
2 ndamë për Qeverinë e Përkohshme në atë kohë kur ka dalë prej
3 Rambujesë e cila ka qenë e vendosur këtu.

4 PY. Dhe kush qëndronte aty, pra, kush e përdorte si bazë?

5 PË. Po zakonisht aty është përdorur si bazë, si qeveri e
6 përkohshme në atë kohë e ka përdorur Hashimi, ka qenë Thaçi
7 edhe pjesë të Qeverisë së Përkohshme. Po folim për kohën e
8 Rambujesë, pas Rambujesë.

9 PY. Atëherë u përdor për herë të parë kjo ndërtesë?

10 PË. Jo. Dhe më herët është përdorur kur edhe na kemi qenë
11 anëtarë të shtabit derisa nuk jemi vendosur në Divjakë.

12 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] A mund të kalojmë në faqen 294,
13 ju lutem?

14 PY. Ndërtesa që shikojmë në fotografitë lart, a e dini se ku
15 ndodhet kjo ndërtesë?

16 PË. Kjo si mbas fotografisë të ngjarjes se kohë ka qenë në
17 fshatin Luzhnicë.

18 PY. Keni qenë ju atje?

19 PË. Po, në qershor të 1998.

20 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të nderuar, kërkoj që të pranohet
21 ky dokument. Për gjuhën shqipe, vetëm atë gamë që përkon me
22 versionin në anglisht, pra, 284 deri në 294. Dhe mund të jetë
23 dokument publik.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
25 kundërshtime?

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk ka
3 kundërshtime.

4 Atëherë dokumenti SPOE00082284 deri në SPOE00082294
5 pranohet.

6 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar, faqet
7 përkatëse dhe përkthimi në gjuhën angleze marrin numrin e
8 provës materiale P01401. Për momentin është dokument
9 konfidencial.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem
11 riklasifikoheni si dokument publik.

12 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Riklasifikohet si
13 dokument publik.

14 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dëshiroj që të shikojmë disa
15 fotografi të tjera. E para është SPOE00229683. Dhe mund të
16 jetë dokument publik.

17 PY. A i njihni personat në këtë fotografi? Dhe në rast se po
18 a mund të na jepni emrat e tyre, ju lutem?

19 PË. Po. Në këtë fotografi gjendem unë, në anën e majtë. Në
20 mes është Hashim Thaçi. Në të djathtë, është Rexhep Selimi.

21 PY. Ku është marrë kjo fotografi, domethënë, ku është vendi?

22 PË. Sa më kujtohet, më duket në Fshatin e Ri.

23 PY. Do të thotë që mund të jetë në atë ndërtesën që pamë që
24 ishte ndërtesa e qeverisë së përkohshme?

25 PË. Po.

1 PY. A e mbani mend me përafërsi se kur është nxjerrë kjo
2 fotografi?

3 PË. Jo, nuk e mbaj mend.

4 PY. A mund të na jepni një periudhë kohore me përafërsi ose
5 disa data me përafërsi?

6 PË. Ka mund të ketë dhe të është dikund nëntor. Nëntor apo --
7 nëntori sigurisht, 1998 mendoj.

8 PY. A mund të shfaqet në ekran -- jo, ndjesë, kërkoj së pari
9 që ky dokument të pranohet.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
11 kundërshtime?

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk ka kundërshtime.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëhere
14 dokumenti SPOE002209683 pranohet.

15 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Kjo fotografi do të
16 marrë numrin e provës materiale P01402 dhe për momentin është
17 dokument konfidencial.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të
19 riklasifikohet, ju lutem.

20 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, të
21 nderuar.

22 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Fotografinë tjetër mund ta
23 shikojmë, pra, është një dokument publik. Ka numrin
24 SPOE00229689.

25 PY. Edhe një herë a mund të na tregoni se kush janë këta

Dëshmitari: Bislam Zyrapi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Lawson (Vazhdim)

Faqe 12

1 persona dhe ku është bërë kjo fotografi?

2 PË. Në këtë fotografi, në anën e majtë, është Jakup Krasniqi,
3 në anën e djathtë është Rexhep Selimi. Mendoj që është i
4 njëjti objekt, të njëjtin vend.

5 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Kërkoj që ky dokument të
6 pranohet, ju lutem.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
8 kundërshtime?

9 Z. ROBERTS: [Përkthim] Jo, nuk ka kundërshtime.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë
11 dokumenti SPOE00229689 pranohet.

12 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Kjo fotografi do të
13 marrë numrin P01403. Dhe me ç'kuptoj mund të riklasifikohet si
14 dokument publik.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

16 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit.

17 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dokumenti i radhës ka numrin
18 SPOE00229700

19 PY. Atëherë, ju lutem, a mund t'i identifikoni këta persona
20 dhe vendin ku është bërë kjo fotografi?

21 PË. Po. Në fotografi në anën e majtë jam unë, në anën e
22 djathtë është Rexhep Selimi. Dhe është në të njëjtin vend si
23 dhe më parë fotografitë.

24 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të nderuar, dëshiroj që edhe ky
25 dokument të pranohet si provë.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
2 kundërshtime?

3 Z. ROBERTS: [Përkthim] Nuk ka kundërshtime.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk ka
5 kundërshtime. Atëherë dokumenti SPOE00229700 pranohet dhe
6 riklasifikohet si publik.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar, kjo
8 fotografi do të marrë numrin e provës materiale P01404 dhe
9 riklasifikohet si dokument publik. Faleminderit.

10 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dokument i radhës që sërish mund
11 të jetë publik, ka numrin SPOE00224887. Nëse mund të kalojmë
12 pak nga fundi i faqes.

13 PY. Dhe edhe një herë, Dëshmitar, nëse mund të na jepni emrat
14 e këtyre individëve dhe vendndodhjen, pra, ku është bërë
15 fotografia.

16 PË. Në fotografi është në anën e majtë Jakup Krasniqi, në
17 anën e djathtë Ramë Buja. Si po shifet nuk e di. Nuk muj me
18 qenë të njëjtin, ndryshe prej atyne fotografive. Mendoj që mos
19 është në shtëpinë e bardhë në Divjakë.

20 PY. Këto objektet e zeza që janë mbi tavolinë. A mund të na
21 thoni çfarë janë?

22 PË. Këto që në tavolinë si objekte të zeza është telefon
23 satelitor.

24 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj që
25 dhe kjo fotografi të pranohet si provë gjyqësore.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka

2 kundërshtime?

3 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Jo.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk ka
5 kundërshtime. Materiali me numër SPOE0022487 pranohet dhe
6 riklasifikohet si material publik.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, të
8 nderuar Gjykatës. Fotografia merr numrin P01405 dhe do të
9 riklasifikohet si material publik.

10 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dokumenti i radhës që po ashtu
11 mund të jetë dokument publik mban numrin SPOE00224894.

12 PY. A mund të identifikoni personin në fotografi dhe
13 vendndodhjen?

14 PË. Po. Është Jakup Krasniqi dhe mendoj që prapë në këtë
15 fotografi është te shtëpia e bardhë në Divjakë, mendoj.

16 PY. Kjo pajisja me ngjyrë të zezë mbi tavolinë, çfarë është
17 mund të na e shpjegoni?

18 PË. Edhe kjo e njëjtë, është telefon satelitor.

19 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Kërkoj që të pranohet kjo
20 fotografi.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
22 kundërshtime?

23 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Nuk ka kundërshtime.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Materiali me
25 numër SPOE00224894 pranohet.

1 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Fotografia do të marrë
2 numrin P01406 dhe klasifikimin aktual e ka konfidencial.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]
4 Riklasifikoheni si dokument publik. Faleminderit.

5 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] E fundit e kësaj vazhde
6 fotografish mban numrin SPOE00229698. Edhe kjo mund të jetë
7 publike.

8 PY. Ju lutem a mund të identifikoni personat në këtë
9 fotografi edhe vendndodhjen?

10 PË. Në këtë fotografi në anën e majtë është Rexhep Selimi, në
11 të djathtë është Fatmir Limaj. Fotografia është bërë në të
12 njëjtin objekt ku dhe më parë i shpjegova fotografi tjera,
13 mendoj që në Fshatin e Ri.

14 PY. Pra, kjo është ndërtesa e Qeverisë së Përkohshme tek
15 Fshati i Ri, apo jo?

16 PË. Po. Mendoj.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Kundërshtoj për këtë lloj
18 pyetjeje, sepse varet në cilën periudhë kohore bëhet fjalë.

19 Pra, ku e bazoni këtë pyetje.

20 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Jo, thjesht unë përsërita
21 përshkrimin që ka bërë dëshmitari më përpara që këtu ka qenë
22 Qeveria e Përkohshme.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Më lejoni. Ai ka dhënë edhe
24 periudhën kohore se kur ka qenë Qeveria e Përkohshme.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mendoj se i

1 referohet të njëjtës ndërtesë. Unë të qartë e kam.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kam probleme me ndërtesën. Dua
3 që të kemi të qartë periudhën kohore.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E kuptoj. Po
5 nuk ishte kjo thelbi i pyetjes. Ishte thjesht identifikimi i
6 ndërtesës.

7 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Faleminderit. Kërkoj që të
8 pranohet dhe ky material.

9 Z. ROBERTS: [Përkthim] S'jam shumë i bindur për
10 relevancën, po përveç kësaj, s'kam ndonjë kundërshtim tjetër.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] SPOE00229698
12 pranohet dhe riklasifikohet si dokument publik.

13 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
14 fotografia merr numrin P01407 dhe do të riklasifikohet si
15 publik.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

17 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Tani, dua t'i kthehemi rendit
18 kronologjik që ndoqëm dhe dje, për këtë do të doja që shfaqej
19 në ekran materiali me numër P00184. Fillojmë tek faqja e
20 fundit, ta shoh fillimisht dëshmitari dhe pastaj rikthehemi
21 tek faqja e parë. Faqja pararendëse, ju lutem.

22 PY. Dëshmitar, e njihni dokumentin?

23 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dhe tani mund të kthehemi tek
24 faqja e parë.

25 DËSHMITARI: Po.

- 1 ZNJ. LAWSON: [Përkthim]
- 2 PY. A e keni përgatitur ju këtë raport?
- 3 PË. Po.
- 4 PY. Ku e keni bazuar këtë?
- 5 PË. Është bazuar në raportet e komandantëve të zonave.
- 6 PY. A ia keni dorëzuar ndokujt këtë raport?
- 7 PË. Çdo herë pas takimit me komandantët e zonave dhe marrje e
8 raporteve nga ata është bërë raporti përmbledhës dhe është
9 dorëzuar ose është dhënë zëvendëskomandantit.
- 10 PY. Kur i thoni zëvendëskomandantit, a mund të na jepni dhe
11 emrin sepse me sa kujtoj unë kanë qenë dy zëvendëskomandantë?
- 12 PË. Po. Në atë kohë më shumti ka qenë Jakup Krasniqi. Jakup
13 Krasniqit ja kemi.
- 14 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Ju lutem shohim provën P001615.
- 15 PY. E njihni këtë dokument?
- 16 PË. Po.
- 17 PY. A është një dokument që është lëshuar prej jush?
- 18 PË. Prej komandës, po.
- 19 PY. Këtu paraqiten problematika raportimi nga komandantët e
20 zonave. Dhe më duket se ju u përgjigjët në fakt pyetjes sime
21 të fundit kur ju thashë çfarë bëtë me një raport të tillë kur
22 e merrnit?
- 23 PË. Po.
- 24 PY. Kur merrnit -- keni marrë raporte ju në kundërpërgjigje
25 të këtij urdhri?

1 PË. Po, nga komandantët e zonave.

2 PY. Kur i merrnit këto raporte, çfarë bënit më pas me to?

3 PË. Siç e shpjegova dhe më herët, pas marrjes së raporteve
4 nga komandantët e zonave, është bërë raporti përmbledhës dhe
5 është dërguar zëvendëskomandantit për të parë raportin dhe
6 informacionin se çka kanë raportuar komandantët dhe cilat janë
7 kanë kërkesat, dhe cilat janë dhënë udhëzimet për t'i
8 realizuar ato kërkesa.

9 PY. Pasi dorëzonit një raport të tillë ju, a bëheshin më pas
10 pyetje vijuese?

11 PË. Jo gjithnjë. Në ato çka, në qoftë se ka qenë diçka e
12 pakjartë ose që diçka është dashtë të shpjegohet ma tepër,
13 atëherë jo vetëm nga unë që është kërku, po është kërku edhe
14 nga komandantët drejtpërdrejt të sqarohet ma tepër raporti
15 ose kërkesa që është bërë.

16 PY. Kur thua "komandant", e keni fjalën për komandantin
17 përkatës të zonës?

18 PË. Po për komandantët e zonës përkatëse, mvarësisht prej
19 tyre prej kërkesave ose nevojës që ka qenë.

20 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Tani do lutesha të shfaqnit në
21 ekran provën me numër P00621.

22 PY. A e njihni këtë dokument dhe, nëse po, a mund ta
23 përshkruani çfarë është?

24 PË. Po, e njoh. A dokumenti imi, i nënshkruar nga unë. Është
25 me vulë të Shtabit të Përgjithshëm. Është një urdhër të cilët

1 janë dhënë sesi të referojnë ose si referojnë ose raportojnë
2 komandantët e zonave kur të vijnë takimin në shtab dhe çka
3 duhet të përmban ai raport.

4 PY. Shohim që kërkohet të mbahet një takim më 29 dhjetor.

5 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Do ju tregoj dhe një dokument
6 tjetër me të njëjtën datë. Materiali ka numrin SPOE00227859.
7 Edhe ky është një dokument që mund të transmetohet publikisht.

8 PY. Nëse keni nevojë mund ta lexoni, po a ju kujtohet ky
9 takim?

10 PË. Po, më kujtohet ky takim. Ka qenë takimi me drejtoritë e
11 drejtorive të Shtabit të Përgjithshëm.

12 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Shohim pak më poshtë.

13 PY. Këtu thuhet që është bërë një prezantim sa i takon
14 strukturës së Shtabit të Përgjithshëm dhe funksioneve që
15 kishin drejtoritë e ndryshme. A ju kujtohet ta keni bërë këtë?

16 PË. Po.

17 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Shkojmë në faqen 2, ju lutem.

18 PY. Në kryes të faqes tek "Drejtoria e Informative", këtu
19 thuhet që flitet edhe për komandantin, përmendet dhe
20 komandanti edhe shefi i shtabit. A mund të na shpjegoni
21 dallimin midis këtyre të dyjave çfarë keni dash të thoni?

22 PË. Kjo është drejtoria e informimit, ajo në atë kohë duhet
23 ta informon jo veç komandantit, po edhe shefin e shtabit. Kur
24 thuhet "informohen" përdoret edhe ndodhitë që kanë ndodhur për
25 mujt t'i ketë shefi i shtabit në dijeni. Kur thojnë për

1 informimet, numrin s'e di sa raporte mund të mirren edhe nga
2 shefi i shtabit, se raportet e shumta kanë ardhur nga
3 komandantët e zonave te shefi i shtabit, të cilët janë
4 përpunuar dhe janë dërguar te komandanti. Po edhe në qoftë se
5 ka pas nevojë për informim ose në opinion atëherë duhet të
6 kërkohet edhe nga shefi i shtabit informacionet ose raportet
7 për mujt të informon opinionin ose njësitë.

8 PY. Këto raporte të drejtorisë informative ishin me gojë apo
9 me shkrim?

10 PË. Po mvarësisht prej situatave. Më shumë kanë qenë me gojë.

11 PY. A e dini nëse ju personalisht dhe komandanti merrnit të
12 njëjtin informacion apo përmbajtja e raportit ishte disi e
13 ndryshme?

14 PË. Unë në atë kohë, sa më kujtohet, kur ishim në takime
15 merrshim të dytë të njëjtën informacion, po zakonisht
16 informacionet më shumë për mu më kanë interesuar ato çka janë
17 në aspektet ushtarake, kurse komandanti ka pas edhe të tjera.

18 PY. Kur përmendet komandanti këtu, kjo bëhet fjalë për ata që
19 ishin në Kosovë, si për shembull, zëvendëskomandantit apo i
20 referohet, komandantit në Shqipëri?

21 PË. I referohet të dyve edhe komandantit në Shqipëri, po edhe
22 brenda në Kosovë, po ma së shumti cili është në Kosovë se e
23 merr raportin edhe drejtpërdrejt.

24 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Kthehemi tek faqja 1, ju lutem.
25 Edhe pak më poshtë tek shqipja.

1 PY. Këtu thuhet që ka pasur tri njësi vartëse në kuadër të
2 Shtabit të Përgjithshëm. A mund të na e përshkruani cilat
3 ishin këto njësi?

4 PË. Njësitë vartëse, domethënë, në Shtabin e Përgjithshëm
5 kanë fillu ka qenë batalioni vëzhgues, policia ushtarake pranë
6 Shtabit të Përgjithshëm dhe kompania e logjistikës e Shtabit
7 të Përgjithshëm. Këto janë tri njësi që kanë qenë njësi varëse
8 të Shtabit të Përgjithshëm.

9 PY. Fillojmë me logjistikën, a mund të na shpjegoni
10 funksionin dhe cili ka qenë komandanti, ndonëse e di që e keni
11 përmendur një herë gjatë dëshmisë suaj?

12 PË. Logjistika ose njësia e logjistikës pranë Shtabit të
13 Përgjithshëm ka qenë të mbështesë Shtabin e Përgjithshëm në të
14 gjitha aspektet në aspektin logjistik, domethënë, nga ushqimi,
15 veshmbathjet, të gjitha, strehimet të Shtabit të Përgjithshëm
16 dhe shumë të tjera pika kyçe. Komandant i kësaj njësie ka qenë
17 Idriz Hyseni.

18 PY. Kjo ka qenë njësia që qëndronte në atë ndërtesën pranë
19 shtëpisë së bardhë?

20 PË. Po.

21 PY. Flasim për policinë ushtarake tani. A mund të na
22 përshkruani funksionin e policisë ushtarake?

23 PË. Policia ushtarake pranë Shtabit të Përgjithshëm kanë qenë
24 të ruajë Shtabin e Përgjithshëm, objektet e saj, të përcjellë
25 Shtabin e Përgjithshëm në çdo lëvizje ku lëvizë në territorin

- 1 e Kosovës dhe sa herë të lëvizë Shtabi i Përgjithshëm.
- 2 Kryesisht është siguria dhe ruajtja e Shtabit të Përgjithshëm.
- 3 Komandant i kësaj njësie ka qenë Ramiz Sertolli.
- 4 PY. Si ishin përzgjedhur anëtarët e njësitit?
- 5 PË. Anëtarët e njësitit të policisë ushtarake mendoni?
- 6 PY. Po, të njësisë së policisë ushtarake pranë Shtabit të
- 7 Përgjithshëm?
- 8 PË. Po njësitë e policisë ushtarake të Shtabit të
- 9 Përgjithshëm janë përzgjedhur nga të gjitha njësitë, nga të
- 10 gjitha zonat ushtarë me të mirë, me të fuqishëm, me trima dhe
- 11 me të përgatitur.
- 12 PY. Ata caktoheshin nga zonat apo përndryshe kush e bënte
- 13 përzgjedhjen e tyre?
- 14 PË. Zakonisht shtabi ka kërkuar nga komandantët e zonës
- 15 atëherë ata i kanë njoft me mirë ushtarët e veç çfarë janë dhe
- 16 ata i kanë dërguar nalt në Shtab të Përgjithshëm.
- 17 PY. Brenda shtabit kush e bënte kërkesën?
- 18 PË. Atëherë emrat e shtabit nëse doni të thoni kush i ka pas
- 19 në mbikëqyrje? I ka mbikëqyrë dhe i ka trajnu ma tepër
- 20 drejtoria e policisë ushtarake dhe ajo i ka mbikëqyrë ato sesi
- 21 po përgatiten, sesi janë të afta dhe aspektet, mund të jetë
- 22 polic ushtarak. Nga ky aspekt është nga drejtoria e policisë.
- 23 PY. Sa i takon njësitit të vëzhgimit, ju lutem na përshkruani
- 24 fillimisht funksionin?
- 25 PË. Njësia e vëzhgimit ka pas -- është njësi e cila është

1 pranë Shtabit të Përgjithshëm dhe kjo njësi është që vëzhgon
2 territorin komplet të Kosovës si në vëzhgimin e lëvizjes së
3 forcave serbe ose kundërshtarit në tërësi, e cila ka pas një
4 detyrë që ajo t'i vëzhgon, t'i shef, t'i merr informacionet
5 nga ato, cilat janë forcat, çfarë force janë, pastaj armët të
6 cilat përdoren, drejtimet ka janë dhe qëllimet e tyre. Me
7 mundësi. Dhe ato pastaj çdo informacion silleshin në Shtabin e
8 Përgjithshëm pranë drejtorisë operative të cilat përpiloheshin
9 planet për mbrojtje apo sulm në qoftë se, mvarësisht prej asaj
10 çka kërkohet.

11 Dhe kjo njësi ka qenë e shpërndarë në disa vende. Një
12 kompani ka qenë pranë Shtabit të Përgjithshëm, ka qenë në
13 njëjtë në kohën ku ka qenë i vendosur Shtabi i Përgjithshëm në
14 Divjakë. Një kompani ka qenë në Llanishtë dhe një ka qenë në
15 drejtim, në bjeshkët e Sharrit, faktikisht në fshatin
16 Budakovë.

17 PY. Cilët ishin komandantët e kompanive të ndryshme dhe
18 komandanti i përgjithshëm i njësisë së vëzhgimit?

19 PË. Komandantët e njësive, të kompanive, të kompanisë së parë
20 ka qenë komandant Guri, Jetullah Qarri, kompanisë së dytë ka
21 qenun Ajvaz Berisha, që ka qenë pranë shtabit dhe të tretës ka
22 qenë Afrim Basha që ka qenë në Fshatin Budakovë.

23 Dhe në atë kohë folim se kjo njësi ka fillu të zhvillohet
24 nga dhjetori e tutje. Komandanti i batalionit ka qenë Mahir
25 Hasani në fillim. Pastaj, më vonë është ndërrue dhe ka marrë

1 Jetullah Qarri. Dhe nuk di pastaj. Se në prill kam detyrën dhe
2 nuk di më pastaj se kush e ka vazhdue të udhëheqë këtë njësi.
3 PY. Ju thatë që më pas e mori Jetullah Qarri. Përkthyesi nuk
4 e kapi emrin e mëparshëm, ju lutem e përsërisni dhe një herë
5 kush ka qenë përpara Jetullah Qarrit?

6 PË. Përpara Jetullah Qarrit ka qenë Mahir Hasani.

7 PY. Njësia e vëzhgimit është e njëjta si njësia e ndërhyrjes
8 së shpejtë, janë e njëjta gjë?

9 PË. Dëgjoni, ne në atë kohë njësitë e vëzhgimit që kemi pasur
10 si Shtab të Përgjithshëm, zonat, brigadat, janë përdorur këto
11 njësi, jo veç janë përdorë për çështje vëzhgimit, po janë
12 përdorur dhe për një reagim të shpejt për nevojat ku u dasht
13 të reagohet në situata të ndryshme. Kështu që e njëjta njësi
14 është përdorë si reagim i shpejtë për të ndihmuar njësitë në
15 front ose në vijat e frontit. Jo vetëm njësia e vëzhgimit për
16 reagim kanë qenë edhe policia ushtarake e cila ka qenë afër
17 pranë shtabeve si të Shtabit të Përgjithshëm, ashtu që zonave,
18 ashtu të brigadave. Faleminderit.

19 PY. Nga marsi i 1999, me përfaqësi, sa ushtarë kanë qenë
20 pranë Shtabit të Përgjithshëm drejtpërdrejtë?

21 PË. Me njësitë vartëse të cilat i kemi pasur aty, duke i
22 marrë parasysh nuk kanë qenë të gjitha të koncentruar në
23 Divjakë, më duket se kanë qenë afër 300.

24 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, kërkoj që të
25 pranohet dokumenti që sapo diskutova me dëshmitarin. Mban

Dëshmitari: Bislam Zyrapi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Lawson (Vazhdim)

Faqe 25

1 numrin SPOE00227859.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka pasur dy
3 faqe. Doni që të pranohet dhe faqja me numër 860?

4 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po, në fakt, e gjithë gama e
5 faqeve. Sepse kanë qenë tre faqe në total.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë ju
7 lutem na jepni numrin e plotë.

8 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] SPOE00227859 deri në
9 SPOE00227861.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
11 kundërshtime?

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Kemi një kundërshtim, sepse këto
13 dy faqet e fundit po kërkohet të pranohen? S'jemi të qartë. Ja
14 më jepni një çast të lutem sa të konsultohem pak me ekipin.

15 [Përfaqësuesit e Prokurorisë këshillohen]

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Ne kundërshtojmë faqen e fundit.
17 Sepse faqja e fundit s'ka asnjë lidhje me këtë që sapo u
18 diskutua me dëshmitarin.

19 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Mund t'jua tregoj dhe faqen e
20 fundit. Është thjesht vazhdimësi e të njëjtit takim. Në
21 rregull shohim dhe faqen e fundit. Këtu thuhet:

22 "Vazhdim i mbledhjes së paradites".

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Çfarë dallimi
24 ka?

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Është temë tjetër. Nëse ka dijeni

1 dëshmitari për temën atëherë le t'i bëhet pyetja.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjeni, ju
3 lutem.

4 ZNJ. LAWSON: [Përkthim]

5 PY. Dëshmitar, këtu flitet "Kërkesë për raport për
6 veprimtarinë e Tahir Zemajt". Keni dijeni për këtë temë?

7 PË. Po.

8 PY. A ka qenë pjesë e diskutimeve?

9 PË. Po, kemi diskutuar dhe këtë.

10 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Atëherë i nderuar Gjykatës,
11 kërkoj që të pranohet i gjithë dokumenti.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Tani nuk kam më kundërshtime.

13 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Ne i qëndrojmë kundërshtimit
14 tonë sa i takon sekuestrimit të këtyre dokumenteve.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ky
16 kundërshtim rrëzohet.

17 Materiali me numër SPOE00227859 deri në SPOE00227861
18 pranohet dhe riklasifikohet si material publik.

19 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
20 dokumenti, bashkë me përkthimin në gjuhën angleze, merr numrin
21 P01408 dhe do të riklasifikohet si dokument publik.
22 Faleminderit.

23 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] A synoni ta bëni një pushim të
24 shkurtër tani, apo jo?

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

Dëshmitari: Bislum Zyrapi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Lawson (Vazhdim)

Faqe 27

1 Z. Dëshmitar, do bëjmë dhjetë minuta pushim. Mund të
2 dilni nga salla e gjyqit.

3 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
5 Bëjmë dhjetë minuta pushim.

6 --- Seanca ndërpritet në orën 10.02

7 --- Seanca rifillon në orën 10.11

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
9 sillni në sallë dëshmitarin.

10 [Dëshmitari vijon dëshminë]

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë, z.
12 Zyrapi, ne mund të vijojmë me pyetjet e Prokurorisë.

13 Mund të vazhdoni znj. Prokurore.

14 ZNJ. LAWSON: [Përkthim]

15 PY. Sapo kishim diskutuar disa nga njësitet që ishin në
16 vartësi të drejtpërdrejtë të Shtabit të Përgjithshëm.

17 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dhe në ekran dëshiroj të shfaqet
18 prova P00891.

19 PY. A e njihnit këtë dokument?

20 PË. Po.

21 PY. Për cilat njësite bëhet fjalë këtu?

22 PË. Kjo drejtpërdrejtë bëhet për njësinë vëzhguese.

23 PY. Dhe këtu thuhet "Sqarim". A ka ndonjë arsye se përse e
24 keni lëshuar këtë dokument?

25 PË. Po. Se në fillim normalisht është gjithë komandantat nuk

1 kanë ditë se si të raportojnë dhe si kur na e jep përgjegjësi.
2 Me ato është dashtë të precizohet se si -- si veprojnë ata dhe
3 kujt i japin përgjegjësi, ose kujna i raportojnë.

4 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] A mund të vendoset në ekran
5 P00901. Dhe do të fillojmë në faqen 6958.

6 Pra, në anglisht kemi faqen e duhur, por nuk e jam e
7 sigurt nëse në gjuhën shqipe kemi faqen e duhur në ekran. Do
8 të ishte faqja 5 e materialit nëse ju ndihmon. Po,
9 faleminderit.

10 PY. A i njihni këta emra, dhe cilës njësi i përkisnin ata?

11 PË. Këta i përkisnin kompanisë në Budakovë, i cili ishte
12 komandant i kësaj njësie Afrim Basha, që edhe vetë në kuadër
13 të kësaj liste është në fillim, numër 1.

14 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Tani mund të kalojmë tek 6962. Në
15 anglisht kemi faqen e saktë. Ndërkohë që tek shqipja duhet të
16 vijojmë tek faqja tjetër. Në rregull. Faleminderit.

17 PY. Edhe një herë, pyetja im është: A i njihni këta emrat dhe
18 cilës njësi i përkisnin ata?

19 PË. Togu i 1-rë i kompanisë së 2-të, e cila është e -- ka
20 qenë në Budakovë. Dhe disa emra, po, disa, jo.

21 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dhe ju lutem në ekran vendosni
22 faqet e mëpasshme.

23 PY. Edhe një herë pyetja ime është: A i njihni këta emra dhe
24 cilës njësi i përkisnin?

25 PË. E njëjtë. Është toga e 2-të e të njëjtës kompani. Disa

1 emra, po, të njofshëm, i di.

2 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] A mund të kalojmë tek faqja 6967,
3 ju lutem. Dhe në gjuhën shqipe duhet të kalojmë te faqja
4 tjetër.

5 PY. Këtu thuhet që ju keni lëshuar një urdhër apo urdhëresë
6 që njësia speciale nuk ka të drejtë me arrestu askënd. E mbani
7 mend këtë urdhër që keni dhënë?

8 PË. Po.

9 PY. Cila është arsyeja, pse e lëshuat ju këtë urdhër apo
10 urdhëresë?

11 PË. Për arsye se kjo njësi vëzhguese, njësi që reagon në
12 reagime të shpejta, nuk është njësi e cila merret me çështjen
13 e arrestimeve, për arsye se për shkak se është përdorur më
14 herët këto njësiti. Një herë është përdorur nga sht --
15 inspektori i përgjithshëm në një fshat në territorin e zonës
16 së Pashtrikut. Për atë dhe arsye është dhënë ky urdhër.

17 PY. Me "inspektorin e përgjithshëm" e keni fjalën për Rexhep
18 Selimin?

19 PË. Po.

20 PY. Personat ishin -- personat e arrestuar ishin të armatosur
21 apo nuk ishin të armatosur?

22 PË. Nuk është çështje -- nuk u bë arrestimi i atyne por është
23 bërë masë disiplinore për shkak të disiplinës që ka ndodhur në
24 atë fshat dhe është përdorur kjo njësi, ç'ka nuk është dashtë
25 të përdoret në këtë mënyrë. Ajo mund të përdoret në qoftë se

1 personat që duhen të arrestohen ose duhet të merren masa ndaj
2 tyre janë me armë edhe kanë kanosur rrezikun, atëherë mund të
3 përdoren këto njësi si njësi speciale për t'i asgjësuar ato
4 ose për t'i arrestuar. Përndryshe është policia ushtarake dhe
5 kanë mënyra të tjera të komandës të cilët veprojnë nga
6 komandanti poshtë i brigadës, zonës, deri në atë në shtab.
7 PY. Dhe ky urdhër ka të bëjë me arrest, atëherë cila ishte
8 masa disiplinore që përdorte kjo njësi? Ishte ndonjë lloj
9 izolimi për shembull?

10 PË. Për këtë njësi, kurse -- se folëm për njësinë, vetë
11 njësinë, është tjetër. Kjo nuk ka pas të drejtë as të izolon
12 ajo. Dhe vetëm është përdorur në qoftë se grupat, ose palë të
13 cilat është dashtë të mirren masa andaj tyre, kanë pasë armë
14 dhe kanë përdor armë, atëherë kjo ka mujt të përdoret si
15 njësi. Përndryshe, jo për veprime të tjera.

16 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Tani mund të kalojmë tek U000-
17 7325. Dokumenti me këtë numër.

18 PY. A e njihni emrat e individëve që kanë përgatitur këtë
19 raport?

20 PË. Po.

21 PY. Cilës njësi i përkisnin ata?

22 PË. I përkisnin kompanisë në Budakovë, njësisë vëzhguese
23 brenda Shtabit të Përgjithshëm.

24 PY. Ky raportim ka të bëjë me ushtarët e njësisë speciale që
25 janë larguar nga ndërtesa pa autorizimin e komandantit, dhe në

1 fund thuhet që:

2 "Ushtarëve iu dha paralajmërim që në rast se shkaktojnë
3 edhe problemin më të vogël, atëherë do të transferohen në
4 burgun e Shtabit të Përgjithshëm, do të bëhet transferimi në
5 burgun e Shtabit të Përgjithshëm."

6 Atëherë pse duhej të përdorej burgu i Shtabit të
7 Përgjithshëm në këto lloj rrethanash?

8 PY. Në këto rrethana është se është njësia pranë Shtabit të
9 Përgjithshëm. Edhe çdo mosdisiplinë e tyre, moskryerjes së
10 detyrave mund të merren masat nga sektori juridik i cili
11 gjindet pranë Shtabit të Përgjithshëm. Fakti është që në qoftë
12 se dënohet ose paraburgoset për parandalim, zakonisht
13 komandantët e komandantët e kompanive dhe këto më pas mund të
15 A ka nevojë të riklasifikohet?

16 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]
18 Riklasifikohet si dokument publik.

19 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Më lejoni fillimisht të
20 lexoj të gjithë numrin e këtij dokumenti sepse ka katër faqe.

21 SPOE00226491 deri në SPOE00226494 dhe përkthimi në
22 anglisht do të marrin numrin P01423 dhe riklasifikohen si
23 dokumente publikë.

24 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Ju lutem tani të vendosni në
25 ekran materialin me numër P00628.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bislam Zyrapi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Lawson (Vazhdim)

Faqe 60

1 PY. A e njihni këtë urdhëresë dhe a jeni ju personi që e keni
2 lëshuar këtë?

3 PË. Po. Është vula e Shtabit të Përgjithshëm, është
4 nënshkrimi im.

5 PY. Paragrafi 2 ka dhe numër telefon për të raportuar
6 çështjet urgjente. A mund të na thoni të kujt ishin këto
7 numra, duke filluar nga numri i parë që shohim këtu,
8 domethënë, që mbaron me 4112.

9 PË. Po. Këta numrat janë dhënë, domethënë, numri i parë është
10 numri im, si shef shtabi që kam pas telefonin satelitor. I
11 dyti është i oficerit operativës të cilit ka marrë këto
12 raporte. Dhe e treta ë zëvendëskomandanti i Shtabit të
13 Përgjithshëm numri i telefonit të tij ku mund, në qoftë se
14 telefonin e parë ose të dytit nuk mund mirresh dhe mund të
15 mirret i treti.

16 PY. Zëvendëskomandanti është Jakup Krasniqi, kështu?

17 PË. Po, numri i telefonit të tij.

18 PY. Ku ndodheshin këta telefona?

19 PË. Këta telefona ndodheshin në Divjakë pranë nesh. I pari ka
20 qenë te unë në zyrën time. I dyti ka qenë në drejtori
21 operative, faktikisht, në dhomën operative dhe i treti te
22 zëvendëskomandanti te z. Jakupi në zyrën e tij.

23 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Tani shohim dokumentin

24 SPOE00225253.

25 Z. EMMERSON: [Përkthim] U çova në këmbë për t'ju bërë një

1 kërkesë, ju lutem, kur të vendosni dokumente në ekran, a mund
2 ta shohim edhe datën, dua ta shohim datën në dokument, të
3 kuptojmë dhe ne cilën datë ka dokumenti. Sepse vërtetë
4 Prokurorja thotë është i datë s 12 janar, po ama data nuk
5 duket në ekran.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pra, doni që
7 të duket dhe data në dokument?

8 Z. EMMERSON: [Përkthim] Po, pra, është e rëndësishme dhe
9 data.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem
11 sigurohuni që i gjithë dokumenti të shfaqet në ekran ku të
12 duket dhe data.

13 ZNJ. LAWSON: [Përkthim]

14 PY. Dëshmitar, a njihni vulën dhe nënshkrimin në këtë
15 dokument?

16 PË. Po. Është vula e Shtabit të Përgjithshëm, nënshkrimi i
17 Jakup Krasniqit.

18 PY. A ju kujtohet kjo urdhëresë dhe çfarë qëllimi kishte?

19 PË. Po, më kujtohet kjo urdhëresë. Qëllimi i saj ishte që
20 numrat e telefonit të cilët i kanë komandantët e zonave, ne
21 nuk i kishim të gjithë, që të na i dërgojnë dhe t'i kemi këto
22 numrat për shkak të komunikimit dhe indifikimit të tyre.

23 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Kërkoj që të pranohet dhe ky
24 dokument dhe mund të jetë një dokument publik.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka

1 kundërshtime? Nuk ka kundërshtime.

2 Atëherë dokumenti SPOE00225253 pranohet dhe
3 riklasifikohet si publik.

4 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti dhe përkthimi
5 në anglisht do të marrin numrin e prova materiale P01424 dhe
6 riklasifikohet si publik.

7 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ju lutem, për procesverbal, ju
8 lutem i kërkoj Trupit Gjykues edhe një herë të thuhet edhe
9 data e dokumentit. Sepse është e rëndësishme të thuhet me zë
10 për procesverbal dhe data. Vërtetë këtu thuhet është 3 janar.

11 Ka ndonjë arsye pse mos të pyetet dëshmitari gjatë
12 dëshmisë për datën dhe të mos merret e mirëqenë data që shohim
13 në dokument. Që ta kemi të qartë ne për procesverbal dhe të
14 mos jetë nevoja t'i shohim dokumentet nga e para.

15 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Sigurisht, sigurisht është e
16 shkruar në dokument, megjithatë në qoftë se doni unë mund ta
17 bëj dhe me zë.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
19 Ne nuk kemi ndonjë kundërshtim në lidhje me këtë. Do veprojmë
20 në këtë mënyrë.

21 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Atëherë data e këtij dokumenti
22 ishte 3 janar. Tani shohim -- a është pranuar?

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, besoj se
24 jo. Po. Më falni, u pranua, u pranua si dokument.

25 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Në rregull. Shohim dokumentin IT-

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bislime Zyrapi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Lawson (Vazhdim)

Faqe 63

1 05-87 4D00039. Ky dokument mban datën 10 janar.

2 PY. Kush e ka nënshkruar këtë dokument?

3 PË. Ky dokument është i nënshkruar nga zëvendëskomandanti i
4 zonës operative të Pashtrikut Syleman Kollqaku.

5 PY. A njihni këtë përmbajtje, a zbatohet këtu urdhri i
6 mëparshëm që pamë ne?

7 PË. Po.

8 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Kërkoj që të pranohet ky dokument
9 dhe mund të jetë një dokument publik.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
11 kundërshtime? Faleminderit.

12 Dokument IT-05-87 4D00039 pranohet dhe riklasifikohet si
13 publik.

14 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit. Dokumenti
15 merr numrin P01425 dhe riklasifikohet si dokument publik.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

17 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Tani ju lutem të vendoset në
18 ekran dokumenti SPOE00225065. Ky dokument është e mira të mos
19 jetë publik sepse ka disa numra aty në listë dhe nuk e di nëse
20 disa prej këtyre numrave funksionojnë edhe sot e kësaj dite. E
21 di që shqipja është e vështirë për t'u lexuar mbase do të na
22 duhet ta zmadhojmë pak.

23 PY. Tek rreshti 33 në të djathtë të faqes, shohim me shkrim
24 dore emrin "Bislime". E shihni?

25 PË. Po.

1 PY. Edhe numri i telefonit shohim sipër që të shohim në
2 titull dhe numri i telefonit është numri që mbaron me 4112 që
3 thatë se është numri juaj i telefonit, kështu?

4 PË. Po.

5 PY. Në të majtë në të njëjtin rresht, tek rreshti 33, thuhet
6 se ky telefon hyri në përdorim në gusht të 1998. E keni
7 përdorur telefonin në gusht të 1998?

8 PË. Jo. Nuk e kam përdorë në gusht sepse s'e kam pas në atë
9 kohë.

10 PY. Kush ta dha telefonin?

11 PË. Telefonin e kam marrë pastaj nga kur hy në nëntor,
12 telefon timin e kam marrë nga -- prej Shqipërisë e kam pru,
13 prej Tiranës. Atje më është dhënë. Ky mund të ketë qenë në
14 funksion në gusht po atje në Tiranë, jo brenda.

15 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Shohim në krye të faqes tek
16 kolona ku thotë karta.

17 PY. Është një titull ku thotë "Karta Numri". A mund të na e
18 shpjegoni çfarë është kjo?

19 PË. Mundet me kanë kartelat të këtyne telefonave satelitorë
20 dhe numri i ri i tyre.

21 PY. Është edhe një kolon me emërtimin "Faks". Ku ka qenë
22 faksi që kishit ju?

23 PË. Po fakset kanë pasun -- disa kanë pasun fakse. Kanë pasur
24 dhe ata që kanë qenë jashtë, po edhe brenda. Brenda kam pasun
25 dhe unë një te drejtoria operative që është marrë dhe janë

Dëshmitari: Bislam Zyrapi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Lawson (Vazhdim)

Faqe 65

1 dërgue përmes tij. Për tjetër nuk e di. Nuk më kujtohet ku ka
2 pas edhe kush ka pas tjerët.

3 PY. Kur shkuat në Shqipëri në prill të 1999, e mbajtët këtë
4 numër telefoni dhe faksi apo ja dorëzuar dikujt tjetër?

5 PË. Jo, këto telefona dhe fakse të gjitha i kam dorëzuar kur
6 kam dorëzuar detyrën ia kam dorëzuar Agim Çekut.

7 PY. Kujt ia dorëzuar edhe një herë, ju lutem?

8 PË. Ia kam dorëzuar detyrën Agim Çekut ashtu edhe telefonin
9 tim ashtu që e kam pas satelitor, kurse ai i operativës ka
10 jetë në operativë në sallën operative.

11 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Do të doja që të pranohej dhe ky
12 dokument.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, unë nuk kam
14 ndonjë kundërshtim. Por s'ka si të jenë në përdorim ende këto
15 numra telefoni në Kosovë se ka ndryshuar i gjithë sistemi
16 telefonik, kështu që nuk ka asnjë problem që ky dokument të
17 jetë publik.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dakord. Shoh
19 që nuk ka kundërshtime, dokumenti SPOE00220565 pranohet.

20 Sa i takon këtij dokumenti të jetë publik apo
21 konfidencial çfarë doni të thoni?

22 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Nuk kam informacion të
23 mjaftueshëm për të shtuar më shumë seç thashë më herët.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po e bëjmë
25 dokument publik.

Dëshmitari: Bislam Zyrapi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Lawson (Vazhdim)

Faqe 66

1 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Për procesverbal,
2 shqipja e këtij dokumentit ka dy faqe, ndërsa anglishtja ka
3 vetëm një faqe. Numri është SPOE00225065 deri në SPOE00225066,
4 ndërsa anglishtja do të marrë numrin P01426 dhe do të
5 riklasifikohet si dokument publik.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
7 Vazhdoni.

8 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Tani mund të shfaqim në ekran
9 materialin SPOE00226766.

10 PY. A e shihni dhe emrin tuaj mes emrave këtu në dokument,
11 Dëshmitar?

12 PË. Po.

13 PY. Me cilin emër jeni këtu?

14 PË. Përdoret pseudonimi, Blic.

15 PY. Kush ju drejtohej me atë pseudonim?

16 PË. Vetëm Rexhep Selimi.

17 PY. Shohim edhe pseudonime apo shkurtime të tjera nga kolona
18 majtas. Njihni ndonjë prej këtyre pseudonimeve këtu dhe, nëse
19 po, na e thoni ju lutem.

20 PË. Nuk e di, 10, 101, 101, nuk e di kush është. Çeliku, po,
21 Fatmir Limaj. Remi është Rustem Mustafa. Gazetari, s'po më
22 kujtohet, është Shukri Buja. Këto çka i di, pak a shumë i di.

23 PY. Po David kush është e dini?

24 PË. Po, pseudonimin e ka pas ai Daut Harajdinaj.

25 PY. Po Magjupi?

1 PË. Lahi Brahimaj.

2 PY. Po Topi?

3 PË. Është po, Topi, Haxhi Shala.

4 PY. Po Plaku?

5 PË. Plaku ne i kemi thënë të gjithë i kemi thënë Xheladin

6 Gashit.

7 PY. Po për Besnikun e dini kujt mund t'i drejtoheshin me

8 këtë?

9 PË. Kështu si Besnik mund të jetë Besnik Dreshaj ka qenë
10 korrier i shtabit, po mua më kujtohet qashtu tash, nuk e di.

11 Në muj me qenë dhe dikush tjetër.

12 PY. Po Daja i vogël?

13 PË. Daja i Vogël i kemi thënë të gjithë Hysni Sylës.

14 PY. Daja?

15 PË. Daja Azem Sylës.

16 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Kalojmë tek faqja tjetër.

17 PY. Mund të na thoni të kujt janë këta numra telefoni?

18 PË. Po këto numra të telefonit sikur shifet janë të

19 Shqipërisë dhe këta poshtë 00355, telefonisë mobile e

20 Shqipërisë. Po shifet këtu si mbas shkresës së Ramizit. Dhe në

21 anë Sabit Gecit, po Sabit Gecit nuk është numri i Shqipërisë.

22 Këtu shifet që numrat janë tjerë, të shteteve tjera. Kaq.

23 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Kërkoj që të pranohet dhe ky

24 dokument.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka

1 kundërshtime? Me sa shoh kundërshtime nuk ka.

2 Dokumenti SPOE00226766, të dyja faqet pranohen dhe
3 riklasifikohen si dokumente publike.

4 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti dhe përkthimi
5 në gjuhën angleze do të marrë numrin P01427 dhe riklasifikohet
6 si dokument publik. Faleminderit.

7 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Tani t'i kthehemi ngjarjes të
8 janarit të 1999. Në këtë kuadër do të doja që të shfaqej në
9 ekran materiali me numër SPOE00225245.

10 PY. A e njihni vulën dhe nënshkrimin?

11 PË. Po. Vula është e Shtabit të Përgjithshëm, nënshkrimi
12 është i Jakup Krasniqit.

13 PY. A ju kujtohet të jetë bërë ky takimi, kjo mbledhje me
14 komandantët e zonave?

15 PË. Më vonë, po.

16 PY. A është e vërtetë që ndonjëherë Jakup Krasniqi i
17 organizonte mbledhje të tilla me disa komandantë të zonave?

18 PË. Jo. Zëri është çu, kur është çu ftesat janë ftu të gjithë
19 komandantët me ardhun dhe kemi qenë dhe pjesë e shtabit, kam
20 qenë dhe unë prezent në ato takimet.

21 PY. Këtu mund të shohim që është Jakup Krasniqi ai që ka
22 dërguar ftesën. Po a është e vërtetë që ndonjëherë ishte Jakup
23 Krasniqi ai që organizonte këto mbledhje dhe u dërgonte ftesa
24 komandantëve të zonave?

25 PË. Po.

1 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Në këtë pyetje ishin dy pyetje
2 në fakt, një prej këtyre pyetjeve e mori përgjigjen prej
3 dëshmitarit.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.
5 Vazhdoni.

6 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Data e këtij dokument është 15
7 janari i 1999 dhe kërkoj që të pranohet.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
9 kundërshtime? Mesa shoh nuk ka. Dokumenti SPOE00225245
10 pranohet dhe riklasifikohet si dokument publik.

11 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti merr numrin
12 P01428 dhe riklasifikohet si publik bashkë me përkthimin në
13 gjuhën angleze. Faleminderit.

14 ZNJ. LAWSON: [Përkthim]
15 PY. Tani mund të shohim disa nga temat që kanë qenë për
16 diskutim. Një prej tyre ka qenë situata politike analizë e
17 gjithanshme për luftën tonë një vjeçare dhe çështje
18 organizative.

19 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Tani shohim në ekran materialin
20 me numër U009-1983.

21 PY. Po të shikojmë këtu lart në faqe, ka të bëjë me urdhrin
22 që sapo pamë më përpara dhe dëshiroj që të kaloj tek pjesa e
23 përmbajtjes.

24 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Prandaj ju lutem të kalojmë tek
25 faqja 1985.

1 PY. Dhe në paragrafin e fundit tek titulli "Udhëheqja dhe
2 komandimi", thuhet që zona e Dukagjinit ende nuk kishte njeri
3 tek pozicioni i shefit të shtabit. Ishte e saktë kjo në atë
4 kohë?

5 PË. Po, ishte e saktë.

6 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Ju lutem të shfaqet faqja 1988
7 dhe pastaj ajo që mbaron me 89.

8 PY. Dëshmitar, do të shikoni në këtë pjesë që këtu po bëhet
9 një raportim për situatën dhe gjendjen luftarake në zonë. Ju
10 lutem shiheni pikat e ndryshme të saj dhe pastaj pyetja ime do
11 të jetë nëse kjo që është raportuar këtu përkon me njohuritë
12 që kishit ju për situatën në vend në atë kohë.

13 Z. EMMERSON: [Përkthim] Edhe një herë, në rast se
14 dëshmitarit po i kërkohet situata në atë kohë, na duhet të
15 dimë qoftë nga dëshmitari apo Prokurorja se për çfarë kohe
16 bëhet fjalë, për çfarë datash.

17 [Mikrofoni çaktivizuar].

18 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Kjo ka të bëjë me urdhrin që
19 kishte datën 15 janar.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

21 ZNJ. LAWSON: [Përkthim]

22 PY. Po. Vazhdojmë me dokumentet te "Forcat e armikut",
23 shiheni pak atë pjesë dhe më pas kalojmë edhe tek faqja
24 tjetër. Jeni gati të kalojmë tek faqja tjetër apo keni ende
25 nevojë për kohë?

Dëshmitari: Bislrim Zyrapi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Lawson (Vazhdim)

Faqe 71

1 PË. Po.

2 PY. Më thoni ju kut të jeni gati. Dhe pyetja ime është --

3 PË. Po.

4 PY. -- çfarë lexoni këtu nëse përkon me mënyrën sesi e kishit
5 kuptuar ju situatën e brigadave.

6 A mbani mend që të keni marrë këtë lloj informacioni në
7 atë kohë?

8 PË. Në raportin, ky është raporti i komandantit të zonës që
9 është dhënë nga zona e atij që shpjegon për komplet zonën dhe
10 njësi të tij dhe veprimtaria e tyre në atë kohë.

11 PY. Informacioni që pasqyrohet këtu a përkon me informacionin
12 që kishit ju në lidhje me zonën e Dukagjinit?

13 PË. Në raportet kur kemi marrë në atë kohë, me sa më
14 kujtohet, nuk kanë qenë bash të detajizime q'aq shumë. Po të
15 gjitha informacionet nuk i kemi pas të gjitha, po një pjesë të
16 saj po, sa më kujtohet mua.

17 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, kërkoj që ky
18 dokument të pranohet.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
20 kundërshtime? Atëhere dokumenti me numrin U009-1983 pranohet.
21 Dhe faqet deri në numrin 1989, apo jo, Prokurore?

22 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Me ç'mbaj mend unë duhet të jetë
23 1990.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].
25 [Përkthim] Atëherë dokumenti U009-1990 është faqja në të cilën

Dëshmitari: Bislam Zyrapi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Lawson (Vazhdim)

Faqe 72

1 përfundon dokumenti që pranohet. Pranohen dhe riklasifikohet
2 si dokument publik.

3 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Nëse mund të sqaroj një
4 gjë në lidhje me faqet, sepse tregohet faqet me ERN 1985, 1988
5 dhe 1989. Prandaj i lutem Prokurores që të na sqarojë në
6 lidhje me numrat e faqeve.

7 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Bëhet fjalë për dokumentin U009-
8 1983 deri në U009-1990.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Pra, i gjithë dokumenti
10 në tërësinë e vet duhet të pranohet?

11 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po.

12 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] E kuptova. Atëherë ky
13 dokument, së bashku me përkthimin në gjuhën angleze, do të
14 marrë numrin e provës materiale P01429 dhe riklasifikohet si
15 dokument publik. Faleminderit.

16 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Tani nëse mund të kalojmë tek
17 dokumenti me numër ose prova më saktë me numër P00617. Dhe do
18 t'ju lutesha që si fillim të shikonim faqen e saj të fundit.

19 PY. A e njihni vulën tuaj dhe nënshkrimin tuaj, Dëshmitar?

20 PË. Po. Vula është e Shtabit të Përgjithshëm, nënshkrimi
21 është i imi.

22 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Atëherë të shkojmë tani tek faqja
23 e parë e këtij dokumenti.

24 PY. Ky dokument mban datën 20 janar. A është ky një raport që
25 e keni përpiluar ju?

1 PË. Po. Kjo është përmbledhja e raporteve të komandantëve të
2 zonave që kanë raportuar në atë kohë.

3 PY. Dhe ashtu siç thuhet këtu, a ia keni dorëzuar ju
4 zëvendëskomandantit, z. Jakup Krasniqi?

5 PË. Po.

6 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] A mund të shfaqet në ekran tani
7 dokumenti P00647 dhe dëshirojmë faqen e fundit të këtij
8 dokumenti që të shfaqet në ekran.

9 PY. A mund të shikojmë pra, se ç'ishte kjo kur u krijua, mund
10 të na e shpjegoni këtë?

11 PË. Po. Në këtë është një listë të cilat janë vulat e zonave
12 operative dhe nënshkrimet e komandantëve të zonave operative.

13 PY. A u krijua ose u përpilua në të njëjtën mbledhje, në
14 mbledhjen me komandantët e zonave më 20 janar?

15 PË. Po. Me datë është 20 janar, qatë ditë.

16 PY. Dhe për ç'qëllim u bë pra, u bë marrja e të gjitha këtyre
17 vulave dhe dhënia e nënshkrimeve?

18 PË. Për të ditur në cilat vula i kanë dhe nënshkrimet e
19 komandantëve.

20 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dhe tani kërkoj që të shikojmë
21 dokumentin SPOE00227666 dhe të shikojmë faqen e tij të parë.

22 PY. Ky dokument mban datën 21 janar, pra, i bie që është dita
23 e mëpasshme, pra, një ditë pas mbledhjes së komandantëve të
24 zonave. Dhe këtu ka disa shënime nga mbledhja e Shtabit të
25 Përgjithshëm. A keni qenë ju pjesë e këtij takimi, keni marrë

1 pjesë në të?

2 PË. Po.

3 PY. Dhe a është e saktë që ka patur edhe një raportim të
4 themi në lidhje me gjërat që u diskutuan në mbledhjen me
5 komandantët e zonave?

6 PË. Po. Po.

7 PY. Atëherë në këto shënime pasqyrohen dhe një sërë takimesh
8 të tjera në datën 25 janar, 28 janar, 1 shkurt, 4 shkurt. A
9 është e saktë që Shtabi i Përgjithshëm takohej shpesh gjatë
10 kësaj periudhe?

11 PË. Ka pas. Takimi i Shtabit të Përgjithshëm ka mund të
12 ndodhë më shpesh për shkak situatave dhe nevojave që kanë qenë
13 atje në atë kohë, komandantëve, jo, nuk ka qenë më shpesh.

14 PY. Dhe gjatë kësaj periudhe të caktuar kohore, pra javën e
15 fundit të janarit të 1999 dhe javës së parë të shkurtit 1999, a
16 është e saktë që Shtabi i Përgjithshëm takohej në formë
17 relativisht intensive?

18 PË. Po. Si mbas nevojave dhe kërkesave që kanë qenë në atë
19 kohë.

20 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Në ekran të shfaqet dokumenti
21 SPOE00226468 dhe faqja 476 e këtij dokumenti. Data këtu është
22 28 janar.

23 PY. A keni qenë pjesë e kësaj mbledhjeje?

24 PË. Jo.

25 PY. A e dini se për çfarë u diskutua në këto takime, për

1 çfarë kishin të bënin këto takime?

2 PË. Jo, nuk më kujtohet.

3 PY. Tek pika numër 3 thuhet:

4 "Propozime nga zona e Dukagjinit për komandantët e
5 brigadave".

6 Mbani mend që të jenë emëruar rreth kësaj kohe
7 komandantët e brigadave komandantët në zonën e Dukagjinit?

8 PË. Jo, nuk mbaj mend.

9 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dëshiroj që në ekran të shfaqet
10 dokumenti SPOE00225268.

11 PY. A e njihni vulën dhe nënshkrimin këtu?

12 PË. Po. Vula është e Shtabit të Përgjithshëm, nënshkrimi i
13 Jakup Krasniqit.

14 PY. A e mbani mend që të jenë bërë këto emërimet?

15 PË. Nuk më kujtohet. Emërimet ka mund të bëhen se është në
16 pjesët të cilat kanë qenë dhe drejtoria e personelit,
17 faktikisht komandantët e zonave gjithnjë janë -- komandantët e
18 zonave kanë propozuar komandantët e brigadave dhe nalt janë
19 emëruar nga Shtabi i Përgjithshëm. Kështu që nuk më kujtohet
20 koha bash tani, kjo kohë që është shkru ky urdhër. Po shifet
21 që është urdhër i emnimit i dy komandantëve.

22 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] I nderuar, kërkoj që ky dokument
23 të pranohet.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
25 kundërshtime?

1 Z. EMMERSON: [Përkthim] Nuk ka kundërshtime, po për
2 procesverbal duhet të themi që data është 4 shkurt e vitit
3 1999.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E saktë.
5 Meqenëse nuk ka kundërshtime, atëherë dokumenti
6 SPOE00225268 pranohet dhe riklasifikohet si dokument publik.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, të
8 nderuar Gjykatës. Ky dokument së bashku me përkthimin në
9 gjuhën angleze do të marri numrin e provës materiale P01430
10 dhe do të riklasifikohet si dokument publik.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

12 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Tani do t'ju lutesha që në ekran
13 të shfaqet dokumenti, në fakt, prova materiale me numrin
14 P00182, ju lutem të shfaqet faqja përkatëse 379.

15 PY. Data në këtë dokument është data 6 shkurt. Është e saktë
16 që ju keni qenë pjesë e këtij takimi ashtu siç thuhet edhe
17 këtu?

18 PË. Për datën nuk jam i sigurt. Thuhet komandantët e zonave,
19 po ku është mbajtur? Është mbajtur në Divjakë apo është mbajtur
20 diku tjetër?

21 PY. Mund të shikojmë pjesë të ndryshme të përmbajtjes që t'ju
22 ndihmojë me kujtesën.

23 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Atëherë ju lutem të shikojmë në
24 faqen 400. Një faqe më përpara, thjesht që t'i tregojmë
25 dëshmitarit që këtu flet Remiu, por do t'i kthehem edhe kësaj

1 faqeje që sapo pamë në ekran.

2 PY. Këtu, pra, propozimi bëhet që ju të bëheni komandant i
3 përgjithshëm. E mbani mend këtë?

4 PË. Po. Ky takim ka qenë në Drenicë.

5 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Tani të kalojmë tek faqja 402.

6 PY. Atëherë këtu flitet për "Sylën". Kujt i referohemi me
7 këtë emër Sylja?

8 PË. Sylja i referohen komandantit të zonës operative të saj
9 kohe Sylejman Selimit.

10 PY. Dhe këtu shkruhet që ai thotë që emërimet që janë bërë në
11 Shtabin e Përgjithshëm janë shqetësuese dhe përmend Sokol
12 Bashotën dhe Jakup Krasniqin. Pse nuk konsiderohej Sokol
13 Bashota si personi i duhur për punën e zëvendëskomandantit siç
14 bëhet referimi përkatës këtu?

15 PË. Nuk e di. Ky takimi është ky takimi i dytë kur të folim
16 për këtë çështjen bash komandantit kur folin, përpara tij ka
17 qenë dhe një takim tjetër të njëjtës ditë.

18 Mirëpo kur referohemi kësaj çka kanë folun, nuk e di, unë
19 bash për këtë arsye dhe kam kërkuar nga komandant zone përse
20 nuk pranohet Sokol Bashota të është zëvendës. Faktikisht se
21 edhe se takimi i parë u prish për shkak të Sokol Bashotës kur
22 ka hy në takim. Do të thotë, unë nuk kam marrë një përgjigje
23 prej tyre kanë thënë nuk është aktiv, nuk janë të kënaqur me
24 punën e tij. Edhe kanë shprehur këto mendimet e tyre.

25 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Atëherë tani dëshiroj që t'i

1 referohem Shënimit Përgatitor numër 2, në rreshtin 124 të saj.
2 PY. Dhe thjesht do t'ju lexoj tani atë që keni thënë javën e
3 shkuar. Ju keni thënë:

4 "[Dëshmitari] nuk mban mend se kush i ka ngritur këto
5 shqetësime por konfirmon që ankesat kryesisht kishin të bënin
6 me dy zëvendëskomandantët. Në veçanti, komandantët e zonës
7 dëshironin që Bashota të ishte më aktiv dhe dëshironin të
8 dinin se çfarë po bënte ai. Disa nga aspektet organizative
9 ishin pjesë e përgjegjësive të tij".

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Kundërshtoj, i nderuar Gjykatës.
11 Këtu po flitet për shënime nga një takim në datën 6 shkurt,
12 ndërkohë që Prokurorja tani e ka çuar dëshmitarin tek një
13 diskutim që kishte të bënte me një mbledhje në datën 21 janar
14 dhe thjesht nuk besoj që kjo është gjëja e duhur që duhet
15 bërë.

16 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Kërkoj që dëshmitarit t'i
17 lexohet i gjithë paragrafi.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.
19 Vazhdoni, ju lutem.

20 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] I gjithë paragrafi nga Shënimi
21 Përgatitor? Atëherë:

22 "[Dëshmitari] ka thënë që ka qenë i pranishëm në
23 këtë takim dhe që dokumenti pasqyron kujtesën e tij për atë se
24 çfarë ka ndodhur në këtë takim. [Dëshmitari] shkroi një raport
25 duke u bazuar tek procesverbali i takimit, ia kaloj atë

1 zëvendëskomandantit dhe nuk u diskutua më tej kjo çështje.
2 [Dëshmitari] nuk mban mend se kush në mënyrë të veçantë i ka
3 ngritur shqetësimet por konfirmon që ankesat kanë pasur të
4 bëjnë kryesisht me dy zëvendëskomandantët. Në veçanti, me
5 komandantët e zonës që dëshironin që Bashota të ishte më aktiv
6 dhe dëshironin të dinin se çfarë po bënte ai. Disa nga
7 aspektet organizative ishin pjesë e përgjegjësive të tij. Ata
8 gjithashtu dëshironin që të kuptonin rolin e Krasniqit si
9 zëvendës".

10 A mjafton kjo?

11 PY. Atëherë, kjo pjesë që sapo ju lexova, a pasqyron ajo
12 mënyrën sesi e keni kuptuar ju këto çështje që kanë dalë në
13 këtë takim që donin që Sokol Bashota të ishte më aktiv dhe që
14 dëshironin të dinin se me çfarë merrej e çfarë bënte dhe të
15 kuptonin edhe rolin e Jakup Krasniqit si zëvendës?

16 PË. Unë e kam kuptuar ashtu. Por edhe ky takim në përfundim
17 ka përfunduar ndryshe se veç është ndërru dhe komandant i
18 përgjithshëm.

19 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Atëherë mund të kalojmë tek faqja
20 tjetër 403. Dhe këtu vazhdon mbahen shënime gjithmonë me
21 Syleman Selimin.

22 PY. Që thuhet:

23 "Jakup Krasniqi, me gjithë respektin që ka, nuk e
24 meriton, nuk është personi i duhur për postin e
25 zëvendëskomandantit".

1 A e mbani mend që u ngrit kjo çështje nga komandantët e
2 zonës?

3 PË. Po.

4 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Tani të kalojmë tek faqja 406, ju
5 lutem.

6 PY. Atëherë këtu lavdërohen ata që kanë luftuar dhe që kanë
7 kontribuar që nga fillimi. A e mbani mend që ka qenë pjesë e
8 diskutimit asokohe kjo?

9 PË. Po.

10 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Tani dëshiroj të kaloj tek prova
11 ose tek dokumenti më saktë 1D00033.

12 Të nderuar, nëse mund t'ju kërkoj që ta zgjasim pak më
13 shumë. Kam edhe dy tema tjera për të cilat dëshiroj që të bëjë
14 pyetje.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, mund të
16 vijoni.

17 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Ju lutem të kalojmë në faqen 357.
18 Këtu është data 13 shkurt.

19 PY. Dhe mund të shikojmë që çështja diskutohet sërish. Dhe në
20 fund të faqes, shihet që Sylejman Selimi emërohet si
21 komandant. E mbani mend këtë gjë?

22 PË. Po.

23 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dhe tani do të doja që të kalonim
24 në faqen 358.

25 PY. Remi, duket këtu që Remi po flet. Dhe që e mbështet

1 emërimin dhe specifikon edhe një gjë që Shtabi i Përgjithshëm
2 në tërësinë e vet nuk është kontestuar por vetëm disa
3 individë, disa prej personave që janë pjesë e Shtabit të
4 Përgjithshëm.

5 E mbani mend këtë gjë dhe a përkon me mënyrën sesi e keni
6 kuptuar ju këtë lloj diskutimi që u bë?

7 PË. Po, e mbaj mend këtë diskutim.

8 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dhe tani do t'ju lutesha që të
9 kalojmë tek prova materiale P00645. Të shikojmë si fillim
10 faqen e parë të këtij dokumenti. Këto janë shënime së pari nga
11 data 26, por po të kalojmë në faqen tjetër.

12 PY. Këtu shikojmë në fillim të kësaj faqeje, që Rexha ka
13 mbajtur fjalën dhe aty ai po flet në lidhje me diskutimet që
14 kanë ndodhur me komandantët e zonave, është e saktë kjo që po
15 them?

16 PË. Po.

17 PY. [Mikrofoni çaktivizuar]. A e mbani mend këtë lloj raporti
18 që u dha atë ditë?

19 PË. A mund ta shikojmë datën dhe një herë?

20 PY. Ka qenë data 26 shkurt.

21 PË. Nuk e di. Në këtë takim nuk kam qenë unë.

22 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Atëherë do t'ju lutesha që të
23 shikojmë faqen 673. Tek dokumenti në gjuhën shqipe duhet të
24 kalojmë tek faqja tjetër. Po. Faleminderit.

25 PY. [Mikrofoni çaktivizuar]. A mund të na shpjegoni se për

1 çfarë bëhet fjalë këtu?

2 PË. Aty është lista, nuk e di kush e ka shkruar për mendimin
3 se kush duhet të jetë kryeministër për qeverinë e përkohshme.

4 PY. Pra, këtu është një lloj votimi po themi? Mund ta themi
5 këtë gjë?

6 PË. Po është një lloj votimi ose mendimi të cilin e kemi
7 dhënë çdonjëni prej nesh që në atë kohë.

8 PY. A kishte patur diskutime më përpara sa të themi të hidhej
9 në votë kjo gjë, pra, diskutime se kush do të duhet të ishte
10 kryeministri?

11 PË. Jo, më herët jo. Diskutimet u ditën, faktikisht na e
12 kemi ditur që grupi që është dërguar në Rambuje dhe kemi dhënë
13 që të kryeson këtë grup Hashim Thaçi dhe ai normalisht që
14 vazhdon edhe të jetë edhe kryeministri i qeverisë së
15 përkohshme.

16 PY. Pra, për mendimin tuaj ka qenë e qartë që ai do të
17 vazhdonte në atë rol edhe përpara se të themi ky vendim të
18 hidhej në vonë ose të shpreheshin këto mendime?

19 PË. Po, për mua, po.

20 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Tani të kalojmë tek dokumenti
21 SPOE00227862.

22 PY. Keni qenë pjesë e kësaj mbledhjeje, e këtij takimi?

23 PË. Mu nuk më kujtohet që kam qenë në këtë takim. Ky është
24 takim diku -- që është mbajtur këtë datë është kthimi i
25 delegacionit kur është kthye nga Rambuje. Po nuk më kujtohet

1 që kam qenë në atë takim.

2 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Ju lutem të kalojmë tek faqja
3 tjetër. Këtu data është 27 shkurt.

4 PY. Dhe Jakup Krasniqi thotë këtu që ai heq dorë nga
5 pozicioni i zëvendëskomandantit dhe që edhe Sokoli duhet të
6 bëjë të njëjtën gjë. Këto fjalë që thuhet këtu a përkojnë me
7 mënyrën sesi e keni kuptuar ju situatën që Sokol Bashota dhe
8 Jakup Krasniqi e kanë dhënë dorëheqjen nga postet që kishin si
9 zëvendëskomandantë?

10 PË. Po ky është takimi kur jemi taku edhe me delegacionin nga
11 Rambuje. Dhe e cila dhe ka paraqitur punën në Rambuje. Dhe
12 normalisht më kujtohet edhe biseda dhe z. Jakup Krasniqi, i
13 cili ka propozuar këto që të largohet nga ky pozicion.

14 PY. A ndodhi kështu në fakt në atë kohë?

15 PË. Nuk e di. Nuk e mbaj mend më tutje se çka. Po faktikisht
16 se po, se pas kësaj z. Krasniqi ka shkue së bashku me
17 delegacionin në Rambuje është kthyer kur është bërë nënshkrimi
18 edhe në Rambuje dhe pastaj nuk është kthyer më mbrenda. Dhe ka
19 mbetur në Shqipëri.

20 PY. Pra, Fatmiri, që besoj që është Fatmir Limaj, këtu thuhet
21 që:

22 "Propozoj që ne të krijojmë qeverinë sa më shpejt që të
23 jetë e mundur në mënyrë që të minimizohen problemet brenda
24 UÇK-së".

25 A përkon kjo me mënyrën sesi e kishit kuptuar ju situatën

Dëshmitari: Bislam Zyrapi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Lawson (Vazhdim)

Faqe 84

1 që fokusi tashmë kishte kaluar tek emërimet e qeverisë së
2 përkohshme?

3 PË. Po, po. Nga ky moment e tutje ka filluar kjo, ky veprim
4 që të fillohen dhe ngadalë të emërohen dhe në qeverinë e
5 përkohshme.

6 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] I nderuar, mund ta bëjmë pushimin
7 tani. Mund ta ndërpresim seancën.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ta ofroni
9 këtë dokument?

10 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Jo, jo për momentin.
11 Faleminderit.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].
13 [Përkthim] Dëshmitar, për sot mbaruam. Faleminderit që keni
14 qëndruar me ne dhe do të shihemi nesër në orën 9.00. Mund të
15 largoheni nga salla.

16 Por edhe një gjë tjetër, mos e diskutoni çështjen me
17 askënd tjetër jashtë salle. Mos harroni që këtë detyrim
18 vazhdoni ta keni ende. Faleminderit.

19 DËSHMITARI: Po. Faleminderit. E kjartë është.

20 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Asgjë tjetër
22 për sot nga Prokuroria, apo jo? Pra, Prokuroria do të na
23 sjellë ndonjë dëshmitar tjetër sot?

24 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Jo, nuk kemi dëshmitar tjetër. Po
25 për dokumentin e fundit në fakt dëshiroj që të pranohet,

1 kërkoj që të pranohet nga Gjykata, po në fakt u ngatërrova
2 mendova se bëhej fjalë për dokumentin e mëparshëm.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
4 kundërshtime? Nuk dëgjoj kundërshtime.

5 Atëhere dokumenti me numrin SPOE00227862 pranohet dhe
6 riklasifikohet si dokument publik.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Për procesverbalin ERN
8 e plotë e këtij dokumenti është SPOE00227862 deri në 227863.
9 Pra, ky dokument dhe përkthimi i vet në gjuhën angleze, do të
10 marri numrin e provës materiale P01431 dhe riklasifikohet si
11 dokument publik. Faleminderit.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Roberts,
13 kishit diçka për të na thënë?

14 Z. ROBERTS: [Përkthim] Po, i nderuar. Nëse mund të
15 kalojmë në seancë private për mbrojtjen e dëshmitarëve.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem na
17 kaloni në seancë private.

18 [Seancë private]

19 [Seancë private teksti i fshirë]

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25 [Seancë e hapur]

1 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

3 Rifillojmë nesër në orën 9.00.

4 --- Seanca mbyllet në orën 13.12

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25